

Të shtëna me armë në Fushë Kosovë, nuk ka të lënduar



11:25 | 20 Gusht 2020

Gjatë ditës së djeshme, një person nga Fushë Kosova, ka raportuar se një person tjetër i shoqëruar edhe me dy persona të tjerë kanë shtënë me armë në drejtim të tij, me ç ‘rast ia kanë dëmtuar veturën.


Sipas raportit të Policisë së Kosovës, rasti ka ndodhur të mërkurën (dje) rreth orës 13:50, transmeton arbresh.info.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitë policore ku kanë gjetur dhe sekuestruar një gëzhojë.

Siç thuhet në raport, të dyshuarit janë larguar nga vendi i ngjarjes, ndërkaq nuk raportohet për të lënduar.

Ky është njoftimi i plotë:
“Fushë Kosovë 19.08.2020-13:50. Viktima mashkull kosovar ka raportuar se i dyshuari mashkull kosovar i cili kishte qenë së bashku me dy të dyshuar tjerë, kishte shtënë me armë në drejtim të viktimës dhe ia kishte dëmtuar edhe veturën. Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitë policore ku kanë gjetur dhe sekuestruar një gëzhojë. Të dyshuarit ishin larguar nga vendi i ngjarjes. Nuk raportohet për të lënduar e as të arrestuar. Rasti vazhdon të hetohet”./Arbresh.info

Shpërndaje në rrjete sociale



ARMA

FUSHE KOSOVE

Lajmet më të lexuara

Të ngjashme



Të shtëna me armë në Fushë Kosovë, nuk ka të lënduar

— 11:25 | 20 August 2020



Selimi në takim me Brock Bierman: USAID mbetet partner i qëndrueshëm i Republikës së Kosov...

— 11:22 |



Thirrje: Sonte të ndizen qirinjtë në orën 21:00, për profesionistët shëndetësor që vdiqën ...

— 11:20 |

Foto lajm



Këto janë prioritetet e rektorit të ri të UP-së

14:35 | 19 Gusht 2020

Rreth nesh

Arbresh.info është në shërbimin tuaj 24 orë duke u kujdesur që në kohë reale të përcjellë tek ju vetëm lajme të sakta, korrekte dhe profesionale, nga gazetarë profesionist dhe të dëshmuar. Lajmi i saktë është vlera që e diferencon Arbresh.info nga portalet tjera.

Kontakt

Tel: +383 38 224 955
Mob: +383 49 777 000
E-Mail: info@arbresh.info
Redaksia: redaksia@arbresh.info
Adresa: Kompleksi Qafa,
Rruga UÇK, Kati I, Hyrja 1,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Rrjetet sociale

